Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)

01.Nr. zyrtar/ 2026

PROCESVERBAL

Takimi i IV-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026

Data: 20.08.2026 **Vendi:** Komuna e Kaçanikut

Të pranishëm

- Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës
- Xhelal Dema, Nënkryetar i Komunës
- Vahid Hyseni, Stacioni Policor – Kaçanik
- Gazmend Bunjaku, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA)
- Sahit Berisha, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK)
- Fatmir Qaka, EVSB
- Elmihane Malsiu, HANDIKOS
- Naim Hysa, Kryqi i Kuq Komunal
- Ylber Tusha, përfaqësues i bizneseve
- Diana Muhaxheri, përfaqësuese e komunitetit
- Shqiponje Vogliqi Rexhepi, KLSP
- Emrin Dema, Këshilli i Prindërve
- Fidaim Fazliu, KBI

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës, Sabedin Vishi.

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën ndërmjet dy takimeve;
3. Siguria për personat me aftësi të kufizuara (PAK), të moshuarit dhe gratë – identifikimi i barrierave dhe fuqizimi i grupeve lokale të sigurisë;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua nga të pranishmit.

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën ndërmjet dy takimeve

Kryetari i Komunës ia dha fjalën përfaqësuesit të Stacionit Policor në Kaçanik, togerit Vahid Hyseni, për të raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë gjatë periudhës përkatëse.

Vahid Hyseni – Theksoi se situata e sigurisë gjatë kësaj periudhe kishte qenë e qetë, pa probleme serioze, pavarësisht fluksit të shtuar të automjeteve dhe qytetarëve, përfshirë mërgimtarët. Policia kishte zbatuar planin operativ "Vera 2026" dhe kishte angazhuar personelin në dispozicion për të ruajtur rendin dhe sigurinë. Sfidë kishte paraqitur menaxhimi i komunikacionit për shkak të punimeve në qendër të qytetit, por situata ishte menaxhuar në mënyrë të kënaqshme.

Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës – Falënderoi Policinë për gatishmërinë dhe bashkëpunimin me institucionet komunale gjatë periudhës së ngarkuar. Shprehu mirënjohje edhe për qytetarët, të cilët kishin treguar mirëkuptim ndaj vështirësive në komunikacion të shkaktuara nga punimet në qendër të qytetit.

3. Siguria për PAK, të moshuarit dhe gratë – identifikimi i barrierave dhe fuqizimi i grupeve lokale të sigurisë

Kryetari i Komunës e hapi diskutimin lidhur me temën e sigurisë për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe gratë.

Elmihane Malsiu – Në cilësinë e përfaqësueses së personave me aftësi të kufizuara, theksoi se tema lidhej me identifikimin e barrierave arkitektonike që vështirësojnë lëvizjen e PAK, të moshuarve dhe grave. Sipas hulumtimeve të realizuara, kishte përmirësime në shmangien e barrierave, por nevojitej punë e mëtejshme për eliminimin e tyre. Këto kategori përballen edhe me barriera të tjera në jetën e përditshme. Dukuria e qenve endacakë paraqet rrezik për sigurinë e tyre; ajo përmendi edhe një rast në periferi të komunës ku qent me pronar kan rrezikuar seriozisht një qytetar. Gjithashtu, mungojnë të dhëna të mjaftueshme për raportimet lidhur me dhunën fizike ndaj kësaj kategorie. Propozoi që, krahas numrit të telefonit të Policisë, Komuna të ketë një numër kontaktues për raportimin e rasteve. Shprehu interesim të marrë informacione nga institucionet përgjegjëse për masat e ndërmarra.

Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës – Theksoi se për këtë kategori të rëndësishme të shoqërisë nuk mund të bëhet kurrë mjaftueshëm për të siguruar një jetë më të mirë. Komuna, brenda kapaciteteve dhe mundësive buxhetore, ishte përpjekur të krijojë qasje për të gjithë, përfshirë ndërtimin e pjerrinave dhe vendosjen e ashensorëve në institucione. Sa u përket qenve endacakë, Komuna kishte ndarë parcelë dhe mjete financiare për ndërtimin e një strehimoreje gjatë vitit të ardhshëm. Ai shprehu shpresën që kjo çështje të zgjidhej edhe në nivel nacional, pasi paraqet sfidë për të gjitha komunat.

Gazmend Bunjaku – Njoftoi se, sipas informatave të Drejtorisë Komunale të Arsimit, institucionet arsimore kishin krijuar hapësira për qasje të personave me aftësi të kufizuara. Po ashtu, ishin zhvilluar aktivitete të përbashkëta me këto kategori të shoqërisë.

Fidaim Fazliu – Shprehu kënaqësi që institucionet po i kushtonin vëmendje kësaj kategorie. Tregoi se më herët kishte qenë dëshmitar dhe iniciator për të ndihmuar një të ri me aftësi të kufizuara, i cili kishte mbetur pa prindër dhe i vetëm. Pas takimeve me institucionet komunale, ndihma e nevojshme nuk ishte realizuar, prandaj iniciativa ishte vazhduar edhe privatisht. Me mbështetjen e donatorëve, i riu ishte dërguar në një strehimore në Istog. Ai kërkoi të dinte numrin e personave me aftësi të kufizuara në komunë dhe gjendjen e tyre, përfshirë integrimin shoqëror, si dhe nivelin e përkrahjes institucionale lokale dhe qendrore. Veçanërisht ngriti çështjen e vështirësive që këta persona kanë për t'u paraqitur fizikisht në zyrat e pensioneve dhe për të marrë shërbime të tjera administrative. Rikujtoi edhe problemin e qasjes në hyrje të xhamisë.

Elmihane Malsiu – Sqaroi se, sipas informatave që kishte, në komunë kishte afërsisht 400 raste të personave me aftësi të kufizuara, ndërsa 86 persona përdornin karrocë. Nuk kishte të dhëna të sakta për numrin e personave të punësuar, por vlerësoi se punësimi ishte në nivel jo të kënaqshëm. Kushtet jo të mira për arsimim ndikonin edhe në mundësitë e punësimit.

Gazmend Bunjaku – Theksoi se personat me aftësi të kufizuara nuk përballeshin me pengesa për regjistrim në shkolla dhe se ishte përmirësuar vetëdijesimi i fëmijëve për mbështetjen e kësaj kategorie. Sipas tij, gjendja lidhur me qasjen dhe integrimin në institucionet arsimore ishte e mirë; për çdo ankesë, qytetarët mund t'i drejtoheshin Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Elmihane Malsiu – Vlerësoi pozitivisht përkrahjen dhe bashkëpunimin me institucionet dhe shoqërinë civile në aktivitete të ndryshme. Megjithatë, theksoi se kjo kategori ka nevojë për trajtim të veçantë, në mënyrë që t'u lehtësohet familjeve kujdesi ndaj tyre. Ajo tha se kushtet ekonomike mund të jenë të mira në disa raste, por nevojat ndryshojnë dhe institucionet duhet të bëjnë më shumë. Në aspektin shëndetësor, gjendjen e vlerësoi relativisht të mirë, duke përmendur vizitat shëndetësore që ofrohen në shtëpi.

Gazmend Bunjaku – Njoftoi se përmes subvencionimit të udhëtimit përkrahen edhe nxënësit që ndjekin mësimet në shkolla speciale jashtë komunës. Komuna përpiqet të krijojë kushte për këtë kategori dhe ta mbështesë në forma të ndryshme, sipas mundësive. Sa i përket punësimit, ai tha se krijohen përparësi për personat me aftësi të kufizuara, por me rastin e punësimit mund t'u ndërpriten të ardhurat e tjera. Për shërbimet administrative, si paraqitja në zyrat e pensioneve, ai vlerësoi se niveli regjional duhet ta lehtësojë këtë problem përmes ekipeve që ofrojnë shërbime në shtëpi. Lidhur me qasjen në hyrje të xhamisë, tha se ishin bërë matjet, por ndërhyrja e kërkuar ishte e pamundur për shkak të shkallëve historike prej guri dhe kufizimeve për ndërhyrje në trotuar. Si alternativë, përmendi mundësinë e përdorimit të pjesës së sipërme, ku qasja mund të jetë më e mirë.

Elmihane Malsiu – Ngriti shqetësimin se një numër i konsiderueshëm i të moshuarve jetojnë vetëm, pa mbikëqyrje, dhe kërkoi të dinte nëse institucionet kanë të dhëna për numrin e tyre dhe si mund të ndihmohen.

Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës – Njoftoi se kjo çështje ishte shqyrtuar dhe se niveli qendror kishte kërkuar ndarjen e një parcele për ndërtimin e një objekti rehabilitues, por realizimi i projektit i takon nivelit qendror. Së bashku me këshilltarin e Ministrit të Shëndetësisë ishte vizituar sanatoriumi për të shqyrtuar mundësinë e ndërtimit të një spitali ose qendre rehabilituese. Për këtë çështje kishte kërkuar edhe takim me Ministrin, por takimi ende nuk ishte realizuar.

Naim Hysa – Propozoi që të moshuarit që jetojnë vetëm të ndihmohen edhe përmes aktiviteteve dhe subvencionimit të OJQ-ve, të cilat mund të angazhojnë vullnetarë për vizita, shoqërim dhe ndihmë në punët e shtëpisë. Tregoi se Kryqi i Kuq kishte zbatuar më herët projektin "Pleqtë pa Mbikëqyrje", të financuar nga Kryqi i Kuq Britanik, ku përzgjedhja e përfituesve bëhej sipas kritereve.

4. Të ndryshme

Naim Hysa – Pyeti për numrin e raportimeve për gjuajtje me armë gjatë sezonit dhe për masat e ndërmarra.

Vahid Hyseni – Njoftoi se deri në atë kohë ishin raportuar dy raste të gjuajtjes me armë. Kur Policia ka burime të sigurta informacioni, ndërhyn menjëherë; ndërsa në rastet që lidhen me ahengje ose thirrje anonime, pa autorizimin e Prokurorit nuk mund të ndërmerren veprimet përkatëse. Rastet përcillen në procedura hetimore dhe gjyqësore.

Fatmir Qaka – E pyeti Drejtorinë Komunale të Arsimit nëse ishin përfunduar përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor dhe nëse mësimi do të fillonte me kohë.

Gazmend Bunjaku – U përgjigj se ishin bërë përgatitjet e nevojshme për fillimin e mbarë të vitit shkollor dhe se mësimi do të fillonte me kohë. Njoftoi gjithashtu se po punohej në disa kontrata për mirëmbajtjen e objekteve shkollore dhe sanimin e dëmtimeve në disa shkolla.

Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës – Ngriti shqetësimin për ankesat e qytetarëve lidhur me sigurinë në komunikacion, veçanërisht për vozitësit që lëvizin me shpejtësi të papërshtatshme. Njoftoi se do të bëhej një vlerësim i gjendjes së rrugëve dhe do të shqyrtohej vendosja e pengesave fizike për parandalimin e shpejtësisë së automjeteve.

Vahid Hyseni – Njoftoi se Policia kishte huazuar një radar nga njësiti rajonal dhe kishte identifikuar disa pika ku dyshohej se nuk respektoheshin rregullat e komunikacionit. Kamerat e sigurisë po ndihmonin në zbulimin e rasteve. Pavarësisht rritjes së numrit të personelit, mbulimi i tërë territorit mbetej sfidë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të automjeteve policore. Sugjeroi shtimin e kamerave në bulevard, ku ka frekuentim të madh të të rinjve dhe ku, sipas tij, disa hapësira shfrytëzohen për veprimtari të paligjshme, përfshirë përdorimin e narkotikëve. Shtoi se për fillimin e vitit shkollor ishte përgatitur një plan operativ në bashkëpunim me drejtorët e shkollave për parandalimin e kësaj dukurie.

Emrin Dema – Vlerësoi se vendosja e kamerave të sigurisë ishte hap pozitiv, por kërkoi që ato të vendoseshin edhe në lokacione të tjera ku ekzistojnë indikacione për keqpërdorime. Si shembull përmendi hyrje-daljen e qytetit në fshatin Bob, ku më herët kishte pasur kamerë, por ajo tashmë nuk ishte e vendosur.

Naim Hysa – Ngriti shqetësimin për bllokimin e rrugës nga Varrezat e Dëshmorëve deri në fshatin Stagovë gjatë ndeshjeve të futbollit, për shkak të parkimit të automjeteve.

Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës – Konfirmoi se ishte në dijeni të këtij shqetësimi. Edhe pse ishte krijuar hapësirë e mjaftueshme për parking, rruga vazhdonte të bllokohej. Vlerësoi se patrullat e Policisë duhet të kalojnë në këtë pjesë, sidomos gjatë ndeshjeve të klubit "Lepenci".

Vahid Hyseni – U zotua se shqetësimi do t'i përcillej njësisë operative të Policisë, me qëllim që në ndeshjet e ardhshme të përmirësohet gjendja.

Në përfundim, Kryetari i Komunës e mbylli takimin, duke bërë të ditur se pjesëmarrësit do të takohen në mbledhjen e radhës.

5. Rekomandimet dhe çështjet për përcjellje

5. Qasja për personat me aftësi të kufizuara: Të vazhdohet identifikimi dhe eliminimi gradual i barrierave arkitektonike në hapësirat publike dhe institucionet komunale, duke u dhënë përparësi objekteve dhe shërbimeve me qasje të kufizuar.
6. Të dhënat për PAK: Të shqyrtohet mundësia e mbledhjes dhe përditësimit të të dhënave për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë nevojat për shërbime, arsimim, punësim dhe integrim shoqëror, në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat përkatëse dhe duke respektuar privatësinë.
7. Raportimi i rasteve: Të shqyrtohet mundësia e krijimit ose publikimit të një pike kontakti komunale për raportimin e shqetësimeve që prekin PAK, të moshuarit dhe gratë, si dhe të qartësohet mënyra e referimit të rasteve te institucionet kompetente.
8. Qentë endacakë: Të vazhdojnë veprimet komunale për trajtimin e problemit të qenve endacakë dhe përgatitjet për ndërtimin e strehimores, si dhe koordinimi me institucionet e nivelit qendror.
9. Të moshuarit që jetojnë vetëm: Të shqyrtohet krijimi i një evidence të nevojave të të moshuarve që jetojnë vetëm dhe mundësia e mbështetjes përmes vizitave në shtëpi, vullnetarizmit dhe projekteve të OJQ-ve, sipas kritereve të qarta.
10. Shërbimet administrative dhe shëndetësore në shtëpi: T'u përcillet institucioneve kompetente të nivelit regjional/qendror nevoja për lehtësimin e procedurave administrative dhe organizimin e ekipeve mobile për personat që nuk mund të paraqiten fizikisht në zyra.
11. Qasja në hyrje të xhamisë: Të shqyrtohen, në bashkëpunim me përfaqësuesit përkatës dhe duke respektuar kufizimet e objektit, alternativat e mundshme për qasje më të sigurt dhe më të përshtatshme.
12. Gjuajtjet me armë: Policia të vazhdojë trajtimin dhe hetimin e raportimeve për gjuajtje me armë, si dhe informimin e qytetarëve për raportimin e rasteve te organet kompetente.
13. Siguria në komunikacion: Komuna dhe Policia të bashkëpunojnë për identifikimin e pikave me rrezik, kontrollin e shpejtësisë dhe vlerësimin e nevojës për masa të qetësimit të trafikut, në përputhje me rregullat dhe kompetencat përkatëse.
14. Kamerat e sigurisë: Të vlerësohet nevoja për kamera shtesë në bulevard dhe në hyrje-daljen e qytetit në fshatin Bob, duke marrë parasysh vlerësimin e rrezikut, ligjshmërinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
15. Parandalimi i dukurive të dëmshme te të rinjtë: Policia dhe drejtoritë e shkollave të zbatojnë planin operativ për parandalimin e veprimtarive të paligjshme dhe përdorimit të narkotikëve pranë hapësirave ku frekuentojnë të rinjtë.

16. Komunikacioni gjatë ndeshjeve në Stagovë: Policia të planifikojë patrullime gjatë ndeshjeve të klubit "Lepenci" dhe të ndërmarrë masa për të parandaluar parkimin që bllokon rrugën nga Varrezat e Dëshmorëve drejt Stagovës.
17. Përgatitjet shkollore: DKA të vazhdojë përcjelljen e mirëmbajtjes së objekteve shkollore dhe sanimin e dëmtimeve të evidentuara, në mënyrë që procesi mësimor të zhvillohet në kushte të sigurta.

Shënim: Rekomandimet paraqesin çështje për përcjellje institucionale të nxjerra nga diskutimet; nuk shënohen si vendime të votuara, pasi materiali burimor nuk evidenton votim formal për secilën rekomandim.

Procesmbajtësi:Fatmir Qaka

Kryesoi:Kryetari i Komunës

Z.Sabedin Vishi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA